



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË  
PËRMBARUESE GJYQËSORE PRIVATE JONIDA UJKASHI

LN-84236-09-2014

Rr. "Nikolla Jorga", Kulla nr.9, Shk.1, K.5, Ap.29, Tiranë

email: j.ujkashi@gmail.com

NIPT L42101005V

Tel: 04 222 9114



Nr. 1167 Regj

Nr. III Prot

Tiranë më 19.02.2024

URDHËR  
"PËR VENDOSJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE"

Drejtuar: Qendrës Kombëtare të Biznesit Tiranë

Adresa :, Tiranë

Për dijëni : Shoqëria "Sekon Ashensori" sh.p.k me NIPT L22006501Q

Adresa: Blv. Gjergj Fishta, pallati Begeja, Shk.1, K.5, Tiranë

Për dijëni: Subjekti "Verrocchi Group" Sh.p.k me NIPT L81708048N përfaqësuar me autorizim nga Studio Ligjore "Juris Consulting" shpk, Av. Olgert Manelli

Adresa: Rr. Frederik Shiroka, Godina "Alba", Kati 3, Ap.5, Tiranë

Pranë Përmbarese Gjyqësore Private Jonida Ujkashi, me kërkesë të palës kreditore është regjistruar çështja përmbarmore me numër 1167 -2024 regj dhe me palë:

**Kreditor** – Subjekti "Verrocchi Group" Sh.p.k me NIPT L81708048N

**Debitor**- Shoqëria "Sekon Ashensori" sh.p.k me NIPT L22006501Q

**Objekti** – Likuidim Fature

**KONSTATOVA:**

Për titullin ekzekutiv "Faturë Shitje Nr.97, datë 08.10.2022" është lëshuar Vendim Nr.11-2023-4438 (598), datë 01.08.2023 lëshuar nga Gjykata e Shkallës së Parë së Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, sipas të cilit "Lëshohet Urdhëri i Ekzekutimit për titullin ekzekutiv "Faturë Shitje Nr.97, datë 08.10.2022" me debitor Subjekti "Sekon Ashensori" sh.p.k për pjesën e mbetur të pashlyer të detyrimit në shumën 2,550 ( dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë) Euro, si dhe mbi detyrimin të përlllogariten kamatat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi, konkretisht sipas Nenit 5 të Ligjit 48/2014, datë 24.04.2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare"

Në bazë të nenit 519 të K.Pr.Civile nga ana e jonë është marrë vendimi i kalimit në ekzekutim të detyrueshëm duke vendosur masën e sekuestros mbi llogaritë rrjedhëse të subjektit debitor. Për këtë arsye :

Në bazë të neneve 527, 593 e në vijim të K.Pr.Civile , Udhëzimit Nr. 1240/5, datë 15.09.2009 "Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarmor privat",

**URDHËROJ :**

1. Qendrën Kombëtare të Biznesit të vendosi masën e sekuestros konservative mbi aktivin që zotëron debitori, Shoqëria "Sekon Ashensori" sh.p.k me NIPT L22006501Q.
2. Ky aktiv të qëndrojë i bllokuar deri në një urdhër të dytë.
3. Për veprimet apo mosveprimet tuaja na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
4. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren të gjitha masat e parashikuara në neni 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vend do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
5. Ky urdhër mbahet e ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.C kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brenda 5 ditëve nga marja dijeni.

PËRMBARUES GJYQËSOR  
JONIDA UJKASHI

